



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 14, datë 26.10.2016

P Ë R

**MIRATIMIN E LEJES, “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR”,  
PËR PRODHIM HIDROENERGJIE, PËR HEC-ET “GJADËR NR.1/1”;  
“GJADËR NR.1/2”; “GJADËR NR.2”; “GJADËR NR.3”; “GJADËR  
NR.4”; DHE “GJADËR NR.5”, ME VENDNDODHJE NË NJËSITË  
ADMINISTRATIVE QERRET, BASHKIA PUKË; UNGREJ, BASHKIA  
LEZHË; VIG-MNELË, BASHKIA VAU-DEJËS**

Në mbështetje të shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, dhe të vendimit nr.416, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes, “Për përdorim burimi uJOR”, për prodhim hidroenergjie, shoqërisë “S.P.E. Gjadër”, sh.p.k., për HEC-et “Gjadër nr.1/1”, “Gjadër nr.1/2”, “Gjadër nr.2”, “Gjadër nr.3”, “Gjadër nr.4”, dhe “Gjadër nr.5”, me vendndodhje në njësitë administrative Qerret, Bashkia Pukë; Ungrej, Bashkia Lezhë; Vig-Mnelë, Bashkia Vau-Dejës.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

EDI RAMA

Në mungesë

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

NIKO PELESHI

